

FEROLINE[®]

KATALOGU ONLINE



ZGJIDHJE PËR KËDO

Përmbledhësja

Perse FEROLine	Faqe 2-4
Xhami Termik & Mekanizmat	Faqe 5-8
Dyer & Dritare (Plastike, Dru-Alumin)	Faqe 9-14
Dyer & Dritare (Alumin me ure Termike)	Faqe 15-22
Dyer & Dritare (Alumin me DRU)	Faqe 23-26
Grila Role & Persiane	Faqe 27-32
Grila Veneciane & Rjeta Insektesh	Faqe 33-36
Fasada	Faqe 37-44
Kangjella Inox,Alumin,Hekur,Xham	Faqe 45-52
Dyer te Jashtme dhe te Brendshme	Faqe 53-56
Tenda, Mbulesa & Punime te Ndryshme	Faqe 57-62
Showroom & Kontakte	Faqe 63-66

Pse të zgjedhim FEROLine?

1. PËR IZOLIM TERMIK MË TË MIRË

Për efikasitetin energjitik dhe izolimin termik në ndërtesa, rëndësi të madhe kanë dyert dhe dritaret, pasi pikërisht ato janë përgjegjëse për humbjen e 40% të nxehtësisë. Prej 2014, normat evropiane kërkojnë që koeficienti i humbjes së nxehtësisë të jetë më i vogël se 1,4w/m2k. Duke marrë parasysh këtë fakt, Feroline ofron produkte të ndryshme të cilat arrijnë nga 0,8 w/ m2k deri 1,4 w/m2k . Elementi tjetër me shumë rëndësi është xhami, i cili përbën 80% të sipërfaqes së dritares për izolim termik më të mirë, ne rekomandojmë xham dopio termik ose të trefishtë plus ndarës termik të cilësisë së lartë.

2.PËR IZOLIM MË TË MIRË TË ZËRIT

Jeta stresuese dhe rritja e numrit të veturave në qytete të mëdha, na tërheq vëmendjen te një faktor serioz, zhurma, nga e cila varet qetësia dhe shëndeti ynë. Njëri ndër faktorët kryesor për një ambient të brendshëm pa zhurma, është xhami i dritares. Feroline ju ofron një gamë të gjërë të kombinimeve të ndryshme të xhamit, prej të cilave xhamin standard me trashësi 24 mm i cili arrin në 31 dB. Zgjidhje e mirë për zhurmën e padëshirueshme janë dritaret Feroline Security, me xham i cili arrin 34 deri 41 dB. Për izolim më të mirë të zërit shumë me rëndësi janë edhe disa element të tjerë: vula me gomë të trefishtë në kornizë, kombinimi i xhamit, dhe montazhi i mirë i tyre.

3. PËR MBROJTJE MË TË MADHE NGA DIELLI:

Mbrojtja nga dielli në një hapësirë mundet të arrihet me disa produkte - grila të jashtme, grila të brendshme, persianet dhe xhami termik me mbrojtje të lartë. Grilat e jashtme, zgjedhje efektive për problemin e rrezeve të diellit, me gamë të gjërë të produkteve për çdo shije dhe stil. Persianet, mbrojnë dritaret nga ndikimet atmosferike, rrisin sigurinë e shtëpisë dhe në të njëjtën kohë i japin fasadës një stil individual. Grilat e brendshme, janë zgjedhje e mirë për mbrojtjen nga dielli, të cilat mund të përshtaten me arredimin e shtëpisë suaj. Xhami Termik - është një xham i energjisë së lartë dhe ka efikasitetin më të mirë nga mbrojtja e diellit.

4. PËR SIGURI MË TË MIRË

Statistikat tregojnë se vjedhjet më të shpeshta të hajdutëve bëhen përmes dritareve. FEROLine ofron produkte me siguri të lartë, me aksesore të kompanisë prestigjioze gjermane “ROTO” me një minimum prej 2 ose 3 pika sigurie dhe doreza HOPPE Secustik. Për nivel më të lartë sigurie ne rekomandojmë mbyllje sigurie me 5 pika sigurie, doreza HOPPE Secustik dhe të paktën një xham triplex me masat 3.3.1.

5. ZGJIDHJE PËR PJESËN E JASHTME DHE TË BRËNDSHME

“E fundit por jo më pak e rëndësishme.” Shumë njerëz ndërrojnë dritaret e tyre thjesht për shkak të arkitekturës. Ata kanë dëshira specike për përmasat, ngjyrat, etj. Ne mund ti përgjigjemi këtyre kërkesave me një gamë të gjërë produktesh.

Misioni ynë: Rritja e performancës



Misioni ynë është që të sigurojmë një platformë të përshtatshme për të gjitha ndërtimet dhe shërbimet tona, duke ofruar “projektimin”, “zhvillimin” dhe “prodhimin” e produkteve cilësore përmes komunikimit dhe bashkëpunimit të suksesshëm me klientët dhe partnerët tanë.

FEROline i është përkushtuar produkteve cilësore. Ne e mbështesim cilësinë tonë në përmirësimin e një procesi të gjatë dhe përqendrohemi tek prodhimi i produkteve me përgjegjshmëri dhe me kosto ekonomike, i shërbimeve më të mira teknike dhe materialeve më të mira për të gjithë rangun e klientëve dhe partnerëve.

Ne dëshirojmë të krijojmë një marrëdhënie afatgjatë me klientët tanë, të ngritur mbi sigurinë, cilësinë, shërbimin e pakufizuar dhe plotësimin e nevojave të klientëve tanë. Nuk mund të themi që veprojmë drejt sepse jemi të shkëlqyer apo më të mirët në treg, por mund të themi se jemi të përkushtuar në çdo projekt që marrim përsipër.

FEROline pranon dhe aplikon ide, mënyra dhe metoda të reja që motivojnë punonjësit drejt punës me cilësi dhe rendiment të lartë. Me këtë bazë të larmishme produktesh kemi mundur të arrijmë suksese në të gjitha projektet dhe sipërmarrjet tona dhe do të vijojmë të përmirësohemi në të ardhmen.

Objektivi përfundimtar i FEROline është të marrë një rol aktiv në krijimin e një bote më të qëndrueshme në fushën e ndërtimit. Në ekipin tonë ju do të gjeni ekspertizën, përvojën dhe integritetin e nevojshëm për të drejtuar dhe përfunduar projektin tuaj të ardhshëm në kohë dhe brenda buxhetit të planifikuar. Ne inkurajojmë punën në grup duke nxitur bashkëpunimin, mbështetjen dhe shpërblimin e nismave individuale. Ne rekrutojmë vetëm punonjësit më të talentuar dhe ata që kanë entuziasmin e duhur për të na ndihmuar në rritjen e performancës tonë.



FEROline: Zgjidhje për këdo



FEROline u themelua në vitin 1996, në Tiranë, si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Firma ka një eksperiencë mjaft të gjerë në dritare, grila, fasada, etj...

Baza teknike e kompanisë është e përbërë nga një skuadër mjaft e kualifikuar si : arkitekte, Inxhinierë Ndërtimi, Inxhinierë Mekanik, Inxhinierë Elektrik, dhe punëtorë të specializuar në punimin e plastikës, aluminit dhe xhamit.

Vizioni ynë shërben si kornizë që udhëzon çdo aspekt të veprimtarisë sonë duke përshkruar rrugën drejt rritjes dhe fuqizimit të qëndrueshëm dhe cilësor. Shoqëria jonë ka një vizion të qartë të mbështetur në vlerat më të mira dhe në idetë e një stafi të kualifikuar dhe profesionist. Jemi të përkushtuar për t'u bërë një lider në industrinë e ndërtimit, për të krijuar një të ardhme të qëndrueshme për brezat që do të vijjnë. Çelësi i suksesit tonë është angazhimi ynë në cilësi, investimi dhe trajnimi ynë i vazhdueshëm në aplikimin e teknologjive të reja. Një nga prioritetet tona kryesore është ofrimi i kontributit tonë në hapësirat ku jetojmë dhe punojmë.

Objektivi ynë në lidhje me klientët është të kemi sa më shumë klientë të kënaqur në punën tonë.

Në lidhje me produktivitetin, të ofrojmë punime të një cilësie të lartë dhe me standarte Evropiane. Në lidhje me partnerët, të krijojmë një vizion dhe të prodhojmë vlera së bashku me partnerët tanë.

Vlerat tona na orientojnë drejt suksesit. Guximi për të krijuar një të ardhme më të mirë. Bashkëpunimi me klientët përmes një ekipi që merr përsipër përgjegjësi dhe vë në zbatim zgjidhje në situata urgjente. Produktet me cilësinë më të mirë në treg. Vëzhgimi dhe njohja e pritshmërive dhe të nevojave të klientëve tanë.



Izolimi i Zhurmës: Qetësi në shtëpinë tuaj

Izolimi i Zhurmës

Izolimi i zhurmës është shumë i rëndësishëm në kohët që jetojmë duke marrë parasysh zhurmën e vazhdueshme që na rrethon. Izolimi i zhurmës është një tregues që saktëson sesa zhurmë, është i aftë të absorbojë xhami i dritares tuaj. Karakteristikat akustike të xhamit maten në dB (shkallë decibel). Duke marrë parasysh produktet që ndodhen në treg është e rëndësishme të dihet shkalla e zvogëlimit të zhurmave në dB (Decibel):

- 10 dB – zvogëlim zhurme me 30%;
- 20 dB – zvogëlim zhurme me 45%;
- 30 dB – zvogëlim zhurme me 60%;
- 40 dB – zvogëlim zhurme me 85%;

Izolimi i mirë i zhurmave arrihet nga:


Struktura e xhamit – kombinimi i xhamave me trashësi të ndryshme (4+5 mm) krijon absorbim më të mirë të vibrimeve të zhurmave, hapësira midis xhamave, sa më e madhe të jetë distanca ndërmjet xhamave aq më mirë do jetë izolimi. Përveç kësaj, distancat ndërmjet xhamave kanë limitet e veta dhe tejkalimi i këtyre limiteve do të uli izolimin e zhurmave.

Përdorimi i xhamave speciale (si në rastin e xhamit të laminuar) që të ulin tejçimi i zhurmave. Mbushja me gaz – mbushja me gaz (Argon) ndihmon xhamin në rritjen e izolimit të zhurmave dhe termike.

Sipas standarteve evropiane, FEROLINE rekomandon për pallate, shkolla dhe spitale me afërsi në rrugët kryesore dhe udhëkryqeve të përdoret dritarja me izolim të zhurmës 37-39 dB, dhe për shtëpi banimi, shkolla dhe spitale në afërsi të autostradës, aeroportit dhe në afërsi të zonave industriale rekomandohet izolimi i zhurmës 41-45 dB.



Xham i thjeshtë
Izolimi i zhurmës = 25dB



Dopio xham,
Izolimi i zhurmës = 32 dB



Xham i laminuar
Izolimi i zhurmës = 28dB



Xham dopio (me xham të laminuar)
Izolimi i zhurmës = 38 dB

Izolimi Termik: Efiçensë Energjitike

Izolimi i Termik




Xhamat Termik janë të përbërë nga struktura prej dy apo më shumë xhama, në mes të cilave ka hapësirë të ajrit (gas argon), me ndarës të madhësive të ndryshme dhe i mbyllur hermetikisht.

Ndarësi prej alumini, shërben për ndarjen e xhamit, dhe mbyllja e brëndshme së bashku me ajrin krijojnë një mbrojtje perfekte për xhamin. Xhami Termik i bërë sipas rregullave nuk lejon ujë brenda dhe nuk lejon kondensimin e brëndshëm të xhamave. Xhami përbën rreth 80% e hapësirës së dritares dhe ndikon më së shumti në izolimin termik të dritares dhe të komplet shtëpisë tuaj.

Ulja e konsumit të energjisë në ndërtesat moderne është esenciale. Përveç uljes së kostos të ngrohjes në dimër, ne duhet të marrim parasysh edhe uljen e sasisë së energjisë të përdorur për kondicionerët në verë.

Në krahasim me materialet e tjera të ndërtimit, izolimi i pjesëve me xham të veshur me xham termik siguron izolimin e shkëlqyer termal dhe kontroll solar të kombinuar me transparencë të lartë. Kjo u jep mundësi dizajnuesve të përdorin sipërfaqe më të mëdha dritarësh gjë që mundëson më shumë dritë brënda në ndërtesë.

Produkti xhami termik është shumë i preferuar nga arkitektet në mbarë botën. Gama e gjërë dhe dinamika në performancë e veshjeve me film (kotimi) si për xhamin transparent ashtu edhe për atë me ngjyrë jep mundësi për shumëllojshmëri si për sa i takon efektivitetin në energji ashtu dhe në ngjyra.



Mekanizmat: Cilësi dhe siguri të lartë



Mekanizmat: Cilësi dhe siguri të lartë



Karakteristikat kryesore që përcaktojnë aksesorët cilësorë është rezistenca në kohë dhe qëndrueshmëria ndaj erës dhe faktoreve të tjerë natyror. Për këtë element të rëndësishëm të dritareve dhe dritareve, dhe për shkak të cilësisë së lartë FEROLine vendosur të bashkëpunojë me kompaninë gjermane ROTO.

Siguria është një shqetësim gjithnjë i pranishëm për banorët e shtëpisë, nga vjedhjet, jo vetëm për dëmtim të pronës dhe humbjen e të mirave, por edhe efektet e saj psikologjike në mirëqënien e familjarëve.

Roto ofron një gamë të gjerë të produkteve të specifikuar me qëllim gjeografik në rritjen e sigurisë për ndërtime të reja dhe rikonstrukcione.

Kur zgjedhni aksesorët Roto ju mund të keni besueshmëri në njohuritë që ka kompania, pasi çdo produkt prodhohet me standarte më të larta të cilësisë për të siguruar familjen tuaj. Përveç kësaj, Roto është e përkushtuar që të ofrojë produkte të cilat i plotësojnë të gjithë kërkesat e tregut dhe me standartet e performancës ndërkombëtare.

Të gjithë aksesorët Roto, të prodhuara nga makineri dhe sistemet e prodhimit të cilësisë së lartë, janë të certifikuar në përputhje me ISO 9001, standarde ndërkombëtar për sigurimin e cilësisë, kështu që ju mund të jeni i sigurtë në vazhdimësinë e cilësisë dhe jetëgjatësisë të dritareve tuaja.





Dyer dhe Dritaret plastike:

Kohët e fundit në Shqipëri, ashtu si në çdo vënd tjetër të Bashkimit European, kanë filluar të hyjnë në treg edhe produktet plastike. FEROLine operon në këtë fushë me kompani prestigjioze europiane. Plastika shquhet për çmimin e saj optimal, që përshtatet me cilësinë e saj dhe me kursimin e energjisë elektrike në shtëpitë tona. Nëse keni vendosur të keni dicka të veçantë në shtëpinë tuaj, dyert dhe dritaret e FEROLine nuk do tju zhgënjëjnë.

Në fushën e plastikës FEROLine bashkëpunon me kompani prestigjioze si Salamander, Brugmann dhe Wintech. Kompani të cilat kanë qënë goxha të suksesshme në tregun Shqiptar.

Në përgjithësi plastika përdoret në vendet e ftohta me një rezultat të shkëlqyer, por FEROLine ka zgjedhur produktet më të përshtatshme për klimën dhe ekonominë Shqiptare.

BRUGMANN SALAMANDER


Brugmann Salamander

Cilësi e lartë me çmim optimal.

Brugmann ka një traditë 46-vjeçare në prodhimin e profileve PVC (pastike). Brugmann është një ndër pionierët e parë në këtë industri, se së fundmi është bërë pjesë e kompanisë Salamander. Konstante dhe zgjidhje të re të kombinuar me mirëmbajtjen e cilësisë më të lartë të produkteve rezultoi në kompani Brüggmann duke u lidhur me produktet më të larta teknike dhe nivelit të cilësisë jo vetëm në Gjermani, por në të gjithë Europën. Përshkrimi i sistemit Brugmann

Karakteristikat kryesore:

- Profili me 5-dhoma;
- Profili me trashësi prej 72 mm
- Trashësia e mundur e xhamit 24-44mm;
- Izolim më i lartë i zhurmës deri në 50% (+5dB), për shkak të një ndërtimi të veçantë dhe një vulë izoluese më të trashë
- Izolim termik i përkryer
- Siguri më lartë profilet janë të përforuara me shufra çeliku që i bën më të qëndrueshme dhe jetëgjatë.
- Cilësi të jashtëzakonshme - të prodhuara me materiale të cilësisë më të lartë dhe prodhim me makineritë më moderne, këto profile japin mundësinë e prodhimit të produkteve me cilësi të lartë.



SALAMANDER STREAMLINE

Profile sistem Streamline:


Komfort i jetesës nga ana e saj më e bukur.

Zgjedhje e përkryer për ata që vlerësojnë elegancën e dritareve dhe rehatinë e jetesës. Ky profil tërheqës është jo vetëm i përshtatshëm për çdo dizajn dritare, ajo gjithashtu ofron rehati më të madhe dhe reduktion konsumin e energjisë elektrike. Ky profil me 5 dhoma, trashësi 76 mm dhe 2 nivele izolimi garanton izolimin optimal termik si dhe një shkallë të lartë të sigurisë. Jashtëzakonisht tërheqës dhe i lehtë për tu pastruar, ky profil me sipërfaqet e përcaktuara me standarde të reja, garanton qëndrueshmëri dhe lehtësinë e kujdesit.

Për të gjithë ata që kërkojnë besueshmërinë e produkteve të kualitetit të lartë së bashku me një look elegant Streamline është zgjedhja e duhur. Gjithmonë pak më shumë, gjithmonë pak më ndryshe, ky është slogani i profileve Streamline.

Karakteristikat kryesore:

- Dizajn elegant me formë klasike.
- Ekuilibër midis qëndrueshmërisë dhe izolimit termik
- Vula izoluese sigurojë mbrojtje optimale ndaj zhurmës dhe të ftohtit.
- Izolimi termik: $U_f = 1,3 \text{ W} / \text{m}^2\text{K}$
- Izolim akustik deri në 47 dB.



SALAMANDER 3D

Profile sistem 3D

Të kënaqim kërkesat tuaja për dizajn të veçantë.

Për të gjithë ata që dëshirojnë të zgjedhin diçka të veçantë dhe me një pamje të veçantë 3D është profili që bën për të.

Tërheqës, me një trashësi prej 76 mm, është jo vetëm i përshtatshëm për çdo dizajn dritare, ajo gjithashtu jep mundësinë e përdorimit për një nga faktorët më të rëndësishëm në mirëqenien e njeriut e ditës natyrore.

I pajisur me 3 vula izolimi, sistem 3D siguron nivelin më të lartë të izolimit termik dhe sigurinë më të lartë për mbrojtjen nga vjedhjet.


Sistem i sofistikuar për njerëzit me stil, ky është sistem i dritareve me dizajn 3D.

Me 5-dhomat, sistemi Salamander 3D plotëson standardet më të larta në aspektin e izolimit termik dhe stabilitetit. Në dispozicionin tuaj me ngjyrë të bardhë, profili siguron një sipërfaqe jetëgjatë, qëndrueshmëri dhe i jashtëzakonshëm për dyert dhe dritaret.

Profili 3D është gjithashtu në dispozicion tuaj në një zgjidhje të madhe ngjyrash.

Karakteristikat kryesore:

- Shkalla Premium për izolim termik, izolimin e zhurmës dhe mbrojtje ndaj vjedhjeve
- Harqe tërheqëse kanate dhe kornizën
- Izolim me 3 vula (një vulë e brëndshme)
- Izolimi termik: $U_f=1.3 \text{ W/m}^2\text{K}$
- Izolim akustik **deri në 46 dB**.



SALAMANDER BluEVOLUTION



Sistemi Profilin bluEvolution 92.

Dritarja e së ardhmes

BluEvolution 92 bashkon teknologji të lartë orientuar drejt të ardhmes dhe pamje moderne, dizajn pragmatik për brezin e ri të dritareve sipas normave europiane. Profili i optimizuar 6-dhoma me trashësi prej 92 mm prodhon izolim të shkëlqyer termik dhe efikasitetin e shkëlqyer të energjisë. BluEvolution 92 është sistemi i dritares të së ardhmes, jo vetem sepse është pofti më i mirë i kompanisë Salamander, por edhe pse normat e reja europiane po shkojnë drejt paramentrave të këtij profili. BluEvolution 92 është në shumë aspekte vendimi i drejtë për shtëpinë tuaj të re, konvertimin ose rinovimin e pjesës së brëndshme të shtëpisë, si dhe për krijimin e një shtëpie me efikasitet energjitike të lartë. Vula qëndrore përmirëson izolimin termik, rrit gjithashtu edhe izolimin akustik, dhe siguron mbrojtje të besueshme kundër erës dhe shiut. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, bluEvolution 92 është 100% i riciklueshëm, gjë që e bën këtë produkt zgjidhje për të ardhmen.

Karakteristikat kryesore:

- Qëndrueshmëri më të lartë si në temperatura të ulëta ashtu dhe në ato të larta
- Izolim me 3 vula (një vulë e brëndshme)
- Izolimi termik: $U_f = 0,98 \text{ W/(m}^2\text{K)}$
- Izolim akustik **deri në 56 dB**.





Dyer dhe dritaret Alumin:

Në fushën e aluminit FEROLine punon me kompaninë lider në treg Alumil. Më poshtë ju ftojmë të shikoni profilet dhe modelet që mund të përshtaten me shtëpinë tuaj, sidomos duke garantuar cilësinë më të mirë në treg.

Në Shqipëri vazhdon të dominojë alumini i thjeshtë, një zgjidhje që në bazë të saj ka çmimin ekonomik. Por, duke parë ndryshimet klimaterike dhe rritjen në çmimin e energjisë elektrike, FEROLine ka vendosur të përdorë produktet më të mira të aluminit termik. Këto produkte përveç garantimit në jetëgjatësi, ato gjithashtu kanë një siguri më të madhe dhe sigurisht një kursim më të lartë të energjisë elektrike.

ALUMIL me Ure Termike (me hapje)

ALUMIL M9650:

Izolim termik me çmim të përshtatshëm

M9650 është një sistem ekonomik me urë termike dhe shtresë të përforcuar dhe një nivel të kënaqshëm të izolimit. Certifikuar nga instituti gjerman IFT Rosenheim, ky produkt siguron izolimin bazë, dhe mund të kombinohet për të zbuluar estetikën e ndërtimit për shkat të formës së veçantë. M9650 Sistemi M ka të njëjtat karakteristika fizike dhe linjat e projektimit të M 11000 dhe prandaj të dy sistemet mund të përdoren në të njëjtën ndërtesë, pa ndonjë dallim të madh estetik.

Produkti ideal për izolim termik të nivelit bazik. Avantazhi kryesor i këtij sistemi termik është çmimi i ulët i blerjes, por me një cilësi izolimi e përshtatshme për këdo. Izolimi me 3 vula garanton një cilësi dhe stabilitet të lartë dhe një kosto efektive. Sistemi më i përshtatshëm për një zgjidhje ekonomike dhe me karakteristikat e mëposhtme:

Karakteristikat kryesore:

- Cilësi dhe kosto në nivel optimal
- Izolimi termik: $U_f = 3,3 \text{ W} / \text{m}^2\text{K}$
- Izolim akustik deri në 35 dB.



ALUMIL Super Termik (me hapje)

ALUMIL M11000:

Cilësia në dorën tuaj



M11000 është një sistem i gjithanshëm për çdo lloj të dymve dhe dritareve me urë termike, të cilat mund të plotësojnë nevojat e kujtdo, ndaj është dhe një nga profilet më të kërkuar nga shumëllojshmëria e zgjidhjeve që paraqet.

M11000 është një sistem i testuar dhe i besueshëm me hapje, i dizenuar për përdorim në një gamë të gjerë ndërtesash dhe pallatesh. Është e certifikuar për të kënaqur të gjitha aspektet moderne dhe kërkesat për izolim termik, akustik dhe siguri.

Ky sistem është ndër më të mirët që kompania Alumil ka sot në treg, dhe gjithashtu është produkti më i kërkuar nga arkitektët modern për shkak të strukturës së tij. I shquar për izolimin termik dhe për qëndrueshmërinë ndaj faktorëve natyrorë ky mund të jetë profili i duhur për dyert dhe dritaret tuaja, sigurisht duke marrë parasysh edhe izolimin e përkryer termik.

Karakteristikat kryesore:

- Shumëllojshmëri mjaft e madhe dizajnesh
- Mbrojtje kundër vjedhjes WK3
- Izolimi termik: $U_f = 2,3 \text{ W} / \text{m}^2\text{K}$
- Izolim akustik deri në 46 dB.



ALUMIL
Building excellence every day

ALUMIL
Building excellence every day

ALUMIL S450 (me rrëshqitje)

ALUMIL S450 (me rrëshqitje): *Sisteme me rrëshqitje me cilësi optimale*

S450 është një sistem me rrëshqitje me urë termike. Ky sistem jep mundësinë e krijimi të një ndarjeje me izolim termik dhe në të njëjtën kohë jep mundësinë e kursimit të hapësirave të brëndshme të shtëpisë. Është i përshtatshëm për shtëpi të vogla të cilave ju nevojitet shumë hapësira të brëndshme. Sistemi S450 ka një qëndrueshmëri të lartë ndaj faktorëve natyrorë dhe garanton në jetëgjatësi të lartë pasi përbëhet nga alumin i trashë që nuk deformohet.

Karakteristikat e produktit:

- Shina të punuara me inox që i japin fortësi komplet dritares dhe pastrohen lehtë
- Kapaciteti mbajtje të derës rrëshqitëse deri në 200kg
- Me sistemin falcon (ngri-rrëshqit) mund të mbajë deri në 300kg
- I përshtatet strukturave që kërkojnë hapësirë të madhe xhami dhe qëndrueshmëri në hapje-mbyllje
- Izolim termik i jashtëzakonshëm për produkte me rrëshqitje
- Shkallë sigurie e lartë për shkak të mbylljes hermetike në disa pika



ALUMIL S650 (me rrëshqitje)

ALUMIL S650 (me rrëshqitje): *Cilësi dhe izolim termik i përkryer*

Është një kryevepër e profileve me rrëshqitje. Ky profil është profili i vetëm në treg i cili ofron cilësinë e izolimit termik që përfitohet nga dritaret me hapje dhe gjithashtu kursimin e hapësirave të brëndshme të shtëpisë. Nëse dikush do një profil të përshtatshëm për shtëpinë e tij duke patur mundësinë që të mos harxhojë asnjë m² të hapësirës së shtëpisë, atëherë ky profil është i përshtatshëm për atë. Nëse doni një profil që të jetë jetëgjatë dhe i qëndrueshëm ju këshillojmë Alumil S650.

Karakteristikat e produktit:

- Me sistemin falcon (ngri-rrëshqit) mund të krijohet për hapësira të mëdha
- Profilet termike kontribuojnë në përmirësimin e performancës së kursimit të energjisë së ndërtesave
- Izolim termik i jashtëzakonshëm për produkte me rrëshqitje
- Shkallë sigurie e lartë për shkak të mbylljes hermetike në disa pika
- Kombinohet me profile të tjera për të krijuar një shtesë për drenazhin e ujërave të shiut
- Përforcimi me çelik i rrotave dhe performanca e shinave prej INOX-i bëjnë të mundur që rrëshqitja të jetë e qetë dhe e lehtë, paçka peshës e cila mund të jetë deri në 300 kg.



Dyer dhe dritare me palosje (ALUMINI)



Dyer dhe dritare me palosje (ALUMINI):
Cilësi e lartë për hapësira të mëdha

Këto dyer dhe dritare karakterizohen nga qëndrueshmëri dhe rezistenca e madhe, të dyja këto cilësi lidhen me jetëgjatësinë e madhe që ka Alumini si produkt. Por ky produkt ka edhe një avantazh tjetër që është mbrojtja e madhe nga faktorët e jashtëm, izolimi termik (në varësi të profileve) dhe mbyllja hermetike e cila ndihmon në mbrojtjen e biznesit ose shtëpisë tuaj. Këto lloj dyeresh përdoren kryesisht nga lokalet, pasi në periudhën e dimrit ato mbrojnë nga faktorët atmosferike, ndërsa gjatë verës mund të hapen dhe të bashkohen me pjesën e jashtme të biznesit.



Dyer dhe dritare me palosje (VETRATA)



Dyer dhe dritare me palosje (VETRATA):
Pamje e shkëlqyer me dritë të bollshme

Vetratat në ndryshim nga dyert dhe dritaret me Alumin ju japin mundësinë e vendosjes të të gjitha dyerve dhe dritareve të biznesit tuaj vetëm me xham. Në këtë mënyrë ju mund të keni një dyqan, showroom ose çfarëdolloj biznesi të ndërtuar me një vetratë xhami përmes së cilës mund të marketoni ose të ekspozoni produktet tuaja. Ky lloj produkti preferohet të vendoset nëpër rrugët tregtare të qytetit ku fluksi i njerëzve është i madh dhe ndikimi nga ky lloj produkti është akoma më i madh.





Dyert dhe dritaret Dru-Alumin:


Një tjetër "RISI" e FEROLINE është edhe implementimi në Shqipëri të dyerve dhe dritareve me DRU-ALUMIN. Ky produkt garanton cilësinë e aluminit termik, pra izolim termik dhe kursim të energjisë elektrike, ndërthurur me materialin më prestigjioz dhe më klasik në ndërtimin e dritareve "drurin".

Ky lloj produkti ka një qëndrueshmëri të lartë dhe rezistencë ndaj faktorëve natyrorë për shkak të cilësisë së lartë të aluminit, dhe nga brënda ka bukurinë dhe konformitetin e drurit i cili i jep një pamje tjetër ambientit. Këto produkte janë të një cilësie të lartë dhe FEROLINE bashkëpunon me firmat më prestigjioze në Itali për ta sjellë këtë produkt pranë klientëve të saj.

Dyert dhe Dritaret Dru-Alumin "Komart"

Dyert dhe dritaret Dru-Alumin:
Sistem Komart


Një tjetër RISI e FEROLINE është edhe implementimi në Shqipëri i dyerve dhe dritareve me DRU-ALUMIN. Ky produkt garanton cilësinë e aluminit termik, pra izolim termik dhe kursim të energjisë elektrike, ndërthurur me materialin më prestigjioz dhe më klasik në ndërtimin e dritareve "drurin". Ky lloj produkti ka një qëndrueshmëri të lartë dhe rezistencë ndaj faktorëve natyrorë për shkak të cilësisë së lartë të aluminit dhe nga brenda ka bukurinë dhe konformitetin e drurit, i cili i jep një pamje tjetër ambientit. Këto produkte janë të një cilësie të lartë dhe FEROLINE bashkëpunon me firmën prestigjioze italiane KOMART për ta sjellë këtë produkt pranë klientëve të saj.



Dyert dhe Dritaret Dru-Alumin "Alumil"

Dyert dhe dritaret Dru-Alumin:
Sistem Alumil 23000

Sistemet e kompanisë Alumil janë më të mirat në tregun Shqiptar. Dru alumini shquhet për cilësinë e lartë dhe për performancë të shkëlqyer dhe e kombinuar me aluminit të cilësisë së lartë arrihet një produkt në nivel Europian. Nëse keni vendosur të merrni një produkt që të vërë në dukje pamjen e shtëpisë tuaj nga jashtë dhe të japë relaksin e kërkuar në ambientin e brendshëm të saj, ne si FEROLINE ju këshillojmë pikërisht sistemin Alumil M23000.





Grilat:

Grilat i japin shtëpisë një pamje krejtësisht të ndryshuar. Si grilat e thjeshta role ashtu edhe ato persiane mund të dallohen që nga larg dhe përmes ngjyrave dhe kombinimeve të tjera mund ta ndryshojnë komplet pamjen e shtëpisë tuaj.


Grilat e FEROLINE e plotësojnë dritaren dhe rrisin funksionalitetin e saj. Nuk ka rëndësi se cilin model klienti zgjedh pasi çdo produkt ka avantazhet e veta. Mbrojtje të shkëlqyer nga dielli, siguron që shtëpia juaj të jetë më e fresket në muajt e verës, izolim termik më të mirë lartë gjatë dimrit, izolim nga zhurmat. Dhe gjithashtu krijon një pamje më të mirë të fasadës së shtëpisë.

Grila Role Alumini dhe Plastike



Grila Alumini (Roleta) - Janë grilat më standarte të përdorura në Shqipëri. Ato vijnë me kuti alumini dhe shufra alumini të mbushura. Shufrat e mbushura na japin një izolim akoma më të mirë termik dhe na mbrojnë akoma më shumë ndaj faktorëve natyrorë. Një zgjedhje e përshtatshme për këdo që do të ketë një izolim dhe pamje me tërheqje për shtëpinë tuaj.

Grila Plastike (Roleta) - Këto grila janë një risi në tregun Shqiptar. Ato vijnë me kuti plastike dhe shufra plastike, të cilat njihen për qëndrueshmëri dhe izolim ndaj faktorëve natyrorë. Edhe pse grilat plastike nuk janë përdorur shumë ne po shikojmë që dita ditës kjo gjë po ndryshon, dhe nëse doni të jeni një hap përpara të tjerëve, pa shpenzuar shumë, mund të zgjidhni Grilat Plastike të FEROLINE.



Grila me Elektromotor (Roleta) - Teknologjia po avancohet, dhe çdo pajisje në ditët e sotshme ose është elektronike ose është "smart". Edhe FEROLINE si gjithë kompanitë e tjera lider në treg, ka implementuar në sistemin e saj të prodhimit edhe grilat me elektromotor. Imagjinoni, të kenë mundësinë të lëvizni grilat tuaj vetëm me kënaqësinë e një butoni, a ia vlen të investosh dhe jo vetëm të shpenzosh për shtëpinë tuaj?

EDILCAS - Për shumë vite me rradhë klienti shqiptar ka përdorur grilat standarte të jashtme, të cilat vetëm sa e mbulojnë dritaren dhe e mbrojnë ndaj faktorëve natyrorë. Grilat EDILCAS janë grila që integrohen në murin e shtëpisë suaj, dhe që propozohen në vila dhe ndërtesa të reja. Nëse keni një shtëpi ose ndërtim të ri, ne ju këshillojmë të merrni në konsideratë grilat EDILCAS.

Grila Role Alumini dhe Plastike



KUJDES:

Përveç avantazheve dhe përfitimeve të mësipërme Grilat janë një nga mbrojtësit më të mirë të shtëpisë tonë. Ato na japin mundësinë që në mbyllje të plotë të sigurojnë shtëpinë edhe në udhëtime të gjata ose pushime familjare. Efektiviteti i tyre rritet sidomos në rastin e grilave të motorizuara, pasi vetë motorri e bën më të vështirë hapjen ose dëmtimin e tyre.



Grila Persiane



Grila Persiane (të levizshme) - Këto lloj persiane jo vetëm që i japin një bukuri shtëpisë suaj, por edhe mund të përdoren si grila të brëndshme për të përshtatur sasinë e diellit që futet në shtëpi. Fakti që shufrat janë të lëvizshme na jep një mundësi për ti përdorur ato në më shumë se një mënyrë. Persianet me shufra të lëvizshme janë ndër produktet më të kërkuara në tregun Shqiptar pasi prodhohen me cilësi të lartë, varietet ngjyrë dhe imitim druri, të cilat do t'ju lënë me gojë hapur. Nëse dëshironi diçka të veçantë jeni të mirëpritur të këshilloheni me arkitektet tanë për të përmirësuar jo vetëm pamjen por dhe cilësinë e jetesës në shtëpinë tuaj.



Grila Persiane (të palëvizshme) - Persianet i japin bukuri shtëpisë suaj dhe gjithashtu e mbrojnë atë nga faktorët natyrorë dhe jo vetëm. Persianet me shufra të pa lëvizshme japin një garanci në mbrojtjen edhe nga personat e pa dëshiruar, pasi shufrat e palëvizshme kanë siguri dhe qëndrueshmëri për një periudhë të gjatë. Persianet mund ta zbukurojnë shtëpinë tuaj, dhe të përshtaten me fasadën pasi vijnë në një variacion të madh ngjyrash, duke përfshirë madhe mundësinë e imitimit të drurit.

Grila Persiane



Grila të Brëndshme

Grilat veneciane të brëndshme: Këto lloj grilash (të ashtuquajtura edhe grilat zyresh) janë grilat që përdoren më shumë në tregun Shqiptar, sidomos nëpër biznese. Ato i japin një bukuri pjesës së brëndshme dhe të jashtme të ambienteve tuaja dhe gjithashtu ato janë të përshtatshme edhe për shtëpi me dizajn modern.



Grila të Jashtme

Grila veneciane të jashtme: Një tjetër RISI nga FEROLine. Grilat e jashtme janë grilat më të përdorura nëpër Europë në vitin 2014. Ato kryesisht janë përdorur për biznese, objekte me strukturë moderne dhe shtëpi me dritare të mëdha. Avantazhi kryesor i këtyre grilave është se në vende të ngrohta, si Shqipëria, ato mbrojnë në mënyrë të shkëlqyer kundër rrezeve të diellit dhe krijojnë një ambient të freskët dhe të këndshëm.



Rrjetat e Insekteve:

Rrjetat e insekteve përbëjnë produktet më të përdorura gjatë stinëve të ngrohta dhe në zonat bregdetare. Këto rrjeta përdoren kryesisht për të ndaluar insekte të vogla si mizat, mushkonjat, etj, pa penguar rrjedhjen e lirshme të ajrit, por ato pengojnë edhe insekte më të mëdhenj që mund të jenë edhe të dëmshëm për familjen tuaj.

Rrjetat e insekteve prodhohen me alumin të cilësisë së lartë dhe rrjete me figura, nuk nevojitet kujdes i madh në mirëmbajtje, mundësi e krijimit të rrjetave me ngjyra të ndryshme me profilet e aluminit, karakteristikë e rrjetave është se mund të montohen në çdo anë dhe në të njëjtën kohë me grilat; Propozohen në 4 mënyra standarte: statike, roletë, plisse dhe lloje dere.

Rrjetat e Insekteve

Rrjetë insektesh modeli dritare (roll):

Ky lloj modeli ka disa favore në krahasim me modelet e tjera.

1. Ofron ngjitje optimale me kornizën e dritares dhe mbulim optimal të zonës së ajrimit
2. Ka funksionalitet më të mirë si në montim dhe në paraqitje
3. Mundësi e largimit të rrjetës në muajt e dimrit;
3. Mund të montohet në çdo dritare, dhe mund të montohet edhe në praninë e grilave të jashtme;

Rrjete insektesh modeli dere:

Ky lloj modeli përdoret kryesisht për dyert e ballkoneve të cilat mund të lihen të hapura gjatë verës, por edhe mund të përdoret për derën e hyrjes me mentesha të shtrënguara që e bëjnë rrjetën të mbyllet automatikisht.


Karakteristikat kryesore të këtij modeli janë:

1. Qëndrueshmëri e madhe dhe siguri, profil shtesë për mbyllje i cili vihet në mes të kornizës;
2. Mentësja me gjerësi të madhe sigurojnë mbylljen e rrjetës;
3. Propozohet me ngjyra të ndryshme

Rrjetë insektesh modeli me rrëshqitje:

Ky model rrjete përdoret kryesisht për dyert dhe dritaret me rrëshqitje pasi kombinohet në mënyrë të përkryer me to. Një nga avantazhet kryesore që ka ky model është heqja dhe vendosja gjatë muajve të dimrit dhe verës. Modeli me rrëshqitje ka disa karakteristika të veçanta:

1. Mundësi e prodhimit në dimensione të mëdha;
2. Hapja e mirë anash është zgjedhje e shkëlqyer për dyert e ballkonit
3. Të përshtatshme edhe për dritare me hapje
4. Rezistencë e mirë, në hapje dhe mbyllje;





Fasada:

Fasadat janë pjesa më kryesore e ndërtesave të reja dhe moderne që po ndërtohen nëpër Europë.


FEROline i prodhon këto produkte në bashkëpunim me firmën prestigjioze Alumil. Këto fasada karakterizohen nga Siguria (nivele të larta të mbrojtjes nga vandalizmat, zjarri, tymi, tërmeti, etj...), kursimi i energjisë elektrike, mbrojtje ndaj kushteve ekstreme atmosferike, estetike të lartë e kombinuar me prirjet më të fundit arkitekturore.

Fasada Gjysëm Strukturale



Fasada me kapak:



Fasada me kapak: është një fasadë me rendiment shumë të lartë energjistik. Ka gjerësi të dukshme të kolonës dhe traversës dhe kontruksion me çelik për të rritur rezistencën nga trysnia e erës. Kapakët janë të një game të gjërë me dizajn dhe forma të ndryshme.



Fasada me Kapak

Fasada gjysëm-strukturale::

Fasada gjysëm-strukturale është një sistem komplet për fasada me termoizolim. Panelet mbajnë xhamat, duke krijuar një shirit të dukshëm alumini perimetrikisht përreth xhamit. Panelet mbahen prej kolonave, tek të cilat janë të fiksuara me aksesore speciale, të cilat sigurojnë strukturën e fasadës. Panelet mund të jenë fikse ose me hapje nga jashtë.



Fasada me Spider





Fasada me xham Spider:
Fasada me xham Spider është një sistem modern tip "spider" për fasadat xhamore me fiksim pikësor, e realizuar nga profile alumini me anodizim natyral ose me ngjyra të ndryshme. Është sistemi ideal për përdorimin në vitrinat e mëdha të dyqaneve, si edhe për përdorim të jashtëm në objektet bioklimaterike me veshje të dyfishtë.




Fasada Strukturale

Fasada gjysëm-strukturale:
Fasada gjysëm-strukturale është një sistem komplet për fasada me termoizolim. Panelet mbajnë xhamat, duke krijuar një shirit të dukshëm alumini perimetrikisht përreth xhamit. Panelet mbahen prej kolonave, tek të cilat janë të fiksuara me aksesore speciale, të cilat sigurojnë strukturën e fasadës. Panelet mund të jenë fikse ose me hapje nga jashtë.




Thyerëse Dielli



Thyerëse Dielli (Brisole):

Sistemi i mbrojtjes kundra rrezeve të diellit përbën propozimin e FEROLine për hijezimin dhe për ndriçimin fizik të kontrolluar të ndërtesave. Kjo realizohet përmes konstruksionit në formë elipsi që kanë fletët e grilave, të cilat mund të vendosen horizontalisht dhe vertikalisht, të lëvizshme ose fikse. Për më tepër sistemi disponon një gamë shumë të gjërë profilesh speciale për përdorim në hapësirat e destinuara për ajrimin e mjediseve të mbyllura, sic janë objektet me makineri, garazhe, mjedise magazinimi, etj...



Fasada me Kompozit Panel



Fasada me kompozit panel:

Kompozit panel është një produkt i përbërë nga fletë me alumin të mbushura me materiale polietileni, me trashësi 4mm të cilat përdoren për veshjen e jashtme të objekteve dhe ndërtesave me stil dhe dizajn modern. Këto panele vijnë me një shumëllojshmëri mjaft të madhe përmasash dhe ngjyrash, sisteme të plota prej alumini për fiksimin e paneleve, trashësi të ndryshme për përdorim të jashtëm apo të brëndshëm, tabela reklamash, etj...





Kangjellat:

Kangjellat përbëjnë pjesën plotësuese për dekorin e brëndshëm të shtëpisë tuaj. Për këtë arsye ne ju ofrojmë një gamë të gjërë produktesh të përshtatshme me shijet dhe shtëpinë tuaj:

Kangjella ALUMINI

Kangjella ALUMIN dhe XHAM

Kangjella MUR XHAMI

Kangjella INOX


Kangjella INOX dhe XHAM

Kangjella HEKURI

Kangjella Alumini



Kangjella Alumini - Kangjellat më të përdorura në Shqipëri. Kudo që keni shkuar dhe keni parë kangjella jemi të sigurt që kanë qënë prej Alumini pasi 70% e klientëve tanë zgjedhin pikërisht këtë lloj kangjelle. Janë të thjeshta në pamje dhe të thjeshta në montim, prandaj ne të FEROLine i ofrojmë me një çmim special që vështirë të gjendet ne treg.



Kangjella Alumini me Xham



Kangjella Alumini me Xham - Kangjellat e Aluminit me Xham, ofrojnë një pamje krejt ndryshe nga kangjellat me alumin. Shumë persona duan diçka më ndryshe se kangjella të thjeshta. Kangjellat Alumini me Xham, janë po aq praktike sa kangjellat me alumin por kanë një pamje superiore në krahasim me kangjellat e thjeshta. Për këdo që do kangjella alumini por dëshiron diçka më shumë, ne ju rekomandojmë këtë lloj kangjelle.




Kangjella Inox-i



Kangjella INOX - Cilësia e këtyre kangjellave është relativisht më e mirë se kangjellat prej alumini dhe prandaj ofrohet si një zëvendësues për kangjellat e aluminit. Përveç bukurisë, INOX-i ka qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi më të madhe sesa Alumini. Kangjellat e INOX-it përdoren më shumë në konstruksionet e reja pasi dhe vetë INOX-i ka një rrezatim dhe bukuri më të madhe sesa Alumini.

Kangjella Inox-i me Xham

Kangjella INOX me Xham - Kangjellat standarte me INOX kanë bukurinë e tyre por kur shtohet edhe pjesa e xhamit atëherë kemi me të vërtetë një produkt që nuk ka të krahasuar. Një nga produktet më të përdorura nëpër qendra tregtare dhe biznese, mund të vij me një çmim konkurrues edhe në shtëpinë tuaj. Nëse dëshiron diçka të veçantë dhe cilësore ky produkt bën për ju.



Kangjella Hekuri



Kangjella Hekuri -

Dikur klasike dhe të zakonshme për shtëpitë tona, këto kangjella janë kthyer në diçka prestigjoze që vetëm një shtresë e shoqërisë i përdor. Të mos harrojmë që këto kangjella janë me jetëgjatë dhe më të qëndrueshme se kushdo produkt që keni parë më sipër. Përsëri FEROLINE i ofron ato me një varietet të pakrahueshëm dhe me një çmim konkurrues. Nëse keni zgjedhur të bëni diçka të veçantë për shtëpinë tuaj, kangjellat prej hekuri janë zgjedhja juaj.



Kangjella Xhami



Kangjella Mur Xhami -

Keni vënë re disa ballkone që duken sikur skanë fare kangjella. Ose disa të tjerë që duket sikur njerëzit po mbështeten në ajër. Këto janë pikërisht kangjellat mur xhami. Këto lloj kangjellash janë të përshtatshme për shtëpi private, sidomos ato shtëpi buzë detit ose liqeneve. Kushdo që do diçka të veçantë për shtëpinë e tij mund të përdori këto lloj kangjellash. Në ndryshim nga kangjellat e aluminit, këto lloj kangjellash janë të përshtatshme më shumë për ballkone ose veranda sesa për pjesën e brendshme të shtëpisë.






Dyer të Brëndshme dhe të Jashtme:

FEROline bashkëpunon në fushën e dyerve të brëndshme dhe të jashtme me kompaninë prestigjioze Italiane “IMIP”, e cila ka një eksperiencë 40 vjeçare në fushën e dyerve prej druri. Këto dyer janë të një cilësie të lartë me një çmim të përshtatshëm për tregun shqiptar. Ne ju ftojmë të shikoni më poshtë edhe modelet e shumëllojshme që ne ofrojmë.

Dyer të Jashtme



Dyert e jashtme:

Të gjithë e dime sesa e rëndësishme është dera e hyrjes së shtëpisë. Ajo tregon prestigjin dhe bukurinë e shtëpisë dhe gjithashtu paraqet edhe statusin e familjes që jeton aty. Në kohët e sotme përveç bukurisë ka lindur nevoja për dyer që të jenë të qëndrueshme dhe rezistente. FEROLINE dhe IMIP ofrojnë disa nga dyert më të mira në tregun shqiptar, sigurisht duke marrë parasysh cilësinë e lartë të derës dhe bukurinë e saj të jashtme.



Dyer të Brëndshme



Dyert e brëndshme:

Dyert e brëndshme përveç funksionit të ndarjes së dhomave, i japin një bukuri dhe estetike pjesës së brëndshme të shtëpisë. Ato mund të kombinohen me mobilimin ose me dritaret e zgjedhura nga ana juaj për të krijuar një dekor universal për të gjithë shtëpinë.





Tenda Dielli:

Tendat e diellit janë një nga produktet më të përdorura në Shqipëri, sidomos në vilat private ose në apartament. Ato prodhohen me hekur dhe materiale tekstile të cilësisë së lartë, nuk nevojitet kujdes i madh në mirëmbajtje, mundësi e ngjyrave të ndryshme në bazë të ambientit dhe ngjyrës së shtëpisë. Përveç tendave të zakonshme me tekstil, kemi dhe 2 modele të tjera të tendave të diellit, njëri model me strukturë hekuri dhe xham, dhe tjetri me strukturë druri.

Tenda dhe Mbulesa




Tenda Standarte -

Ky është modeli më i thjeshtë me të cilin mund të bëhet një tendë. Çmimi është avantazhi kryesor që kjo tendë ofron dhe për personat që duan një tendë pa harxhuar shumë kohë dhe para ne rekomandojmë tendat standarte. Struktura e këtyre tendave bëhet me materiale të cilësisë së parë, që garantojnë një qëndrueshmëri ndaj faktorëve natyrore. Gjithashtu materialet tekstile janë një garanci më shumë për cilësinë e kësaj tende.



Tenda dhe Mbulesa



Tenda Xhami -

Në një kohë kur çdo gjë po modernizohet çdo ditë dhe më shumë FEROLine ka futur në listën e produkteve të saj edhe tendat prej xhami. Këto lloj tenda prodhohen me strukturë të qëndrueshme INOX-i e cila garanton jetëgjatësinë e kësaj strukturë dhe gjithashtu përmes xhamit të cilësisë së lartë që vendoset mbi këtë strukturë përfitojmë një tendë me cilësi dhe pamje europiane, me një çmim të arsyeshëm. Nëse keni një shtëpi moderne kjo është tenda për ju.

Tenda Druri -

Tenda e përkryer për vila dhe shtëpi private në periferi. Kjo tendë ka filluar të përdoret kohët e fundit pasi modelet e reja të shtëpive private ka filluar të jetë më shumë drejt stilit të dyerve dhe dritareve prej druri ose drualumin, produkt të cilin FEROLine e ofron. Ky produkt ofrohet me një çmim special në tregun Shqiptar dhe me një cilësi të veçantë në stilin e punimit dhe montimit në shtëpitë tuaj. Për çdo person të apasionuar pas shtëpive vintage FEROLine e ka një zgjidhje për ju.



Punime të Tjera:

FEROline ofron edhe disa produkte dhe shërbime të tjera të cilat plotësojnë gamën e gjerë që ofron kompania. Në punimet e tjera ne duam të veçojmë vetëm 3 produkte të cilat ne i konsiderojmë të veçanta. Punimet me hekur (dyer hekuri), Punime Inox-i (tavolinat dhe karriget prej inox-i) dhe Shtresat e ndryshme (parket për shtëpinë ose shtresa për pishina).



Punime të Tjera

Punime hekuri

Dyert e hekurit kryesisht përdoren nga biznese të cilat u nevojiten më shumë se një hyrje, nuk po flasim për hyrje kryesore por për hyrjet dytësore. Këto hyrje mund të përdoren si për shkarkimin ose ngarkimin e mallit ashtu edhe për hyrjen e personelit ose personave të tretë që punojnë në biznesin tuaj. Këto lloj punime FEROLine i realizon përmes bashkëpunimit me kompani të ndryshme duke garantuar cilësinë dhe sigurinë maksimale.



Punime inoxi

Në një epokë ku modernizimi i gjithçkaje është në modë kompania jonë nuk mund të ngelte më prapa. Tavolinat dhe karriget prej inox-i janë një ndër produktet që FEROLine po përdor më shpesh jo vetëm për tregun Shqiptar por edhe në mbarë Europën. Këto lloj produktesh jo vetëm që mund të përdoren në ambiente si zyra ose salla mbledhjesh por edhe në ambiente të hapura pasi janë rezistente ndaj faktorëve natyrorë.




Shtresa dysheme veshje etj

FEROLine disponon edhe grupin e saj të punës që merret me shtrimin e parketeve por në këtë pjesë ne dëshirojmë tju prezantojmë një produkt të ri. Në shumë shtëpi private dhe sidomos ato që disponojnë pishina ose veranda kemi vënë re që po përdoret shumë shtrimi me veshje të ambienteve të jashtme të shtëpisë. Këto materiale janë të përshtatshme për çdo hapësirë të jashtme dhe janë shumë rezistente ndaj faktorëve natyrorë (sidomos ndaj shirave). Prandaj nëse keni një shtëpi me verandë ose një pishinë ju rekomandojmë ti provoni këto produkte speciale që ofron FEROLine.



SHOWROOM



SHOWROOM



SHOWROOM



KONTAKTE

Mos nguroni të na kontaktoni

Telefon: +355682053460 / +355682053461

Email: alfae_shpk@hotmail.com / info@feroline.al

Web: www.feroline.al

